

# Rregullore e Brendshme për Sinjalizimin

*Kuadri i brendshëm i sinjalizimit*

OLO-WB-003 • Armundia Factory sh.p.k. • I Publik

## KREU I — Dispozita të Përgjithshme

### Neni 1 — Objekti dhe qëllimi

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të brendshme të sinjalizimit pranë shoqërisë Armundia Factory sh.p.k. (në vijim "Shoqëria"), në zbatim të nenit 14, pika 3, të Ligjit Nr. 96/2025 "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve" (në vijim "Ligji") dhe të Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nr. 1, datë 30.4.2026 (në vijim "Udhëzimi"). Kjo rregullore përcakton mekanizmin e raportimit dhe ndjekjes së sinjalizimeve të brendshme, organizimin e njësisë përgjegjëse, kanalet e sinjalizimit, të drejtat e sinjalizuesit dhe garancitë e mbrojtjes, konfidencialitetit e mbrojtjes së të dhënave personale.

### Neni 2 — Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në Ligjin Nr. 96/2025, në Udhëzimin nr. 1, datë 30.4.2026, në Ligjin Nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian në masën që bëhet i zbatueshëm nëpërmjet marrëdhënieve ndërkombëtare të grupit, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

### Neni 3 — Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për çdo punonjës, drejtues dhe person që ushtron veprimtari pranë Shoqërisë, pavarësisht nga natyra ose kohëzgjatja e marrëdhënies, përfshirë kandidatët për punësim, ish-punonjësit, bashkëpunëtorët, vetëpunësuarit, aksionarët, anëtarët e organeve drejtuese e mbikëqyrëse, furnitorët, nënkontraktorët dhe çdo person që vepron nën mbikëqyrjen e tyre. Rregullorja u vihet në dispozicion të gjithë punonjësve dhe publikohet në sistemin elektronik të brendshëm; askush nuk mund të justifikohet me mosnjohjen e saj.

### Neni 4 — Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje: (a) "Sinjalizim" është raportimi i informacionit për një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryer ose që pritet të kryhet në një kontekst pune; (b) "Sinjalizues" është personi fizik që sinjalizon ose bën publik informacion mbi shkelje, të cilin e ka marrë në kontekstin e veprimtarisë së tij të punës; (c) "Person i përfshirë" është çdo person fizik ose juridik që përmendet në sinjalizim si autor i shkeljes ose si i lidhur me të; (ç) "Persona të lidhur me sinjalizuesin" janë bashkëshorti, bashkëjetuesi, të afërmit dhe kolegët që mund të

#### ARMUNDIA FACTORY SHPK

Bulevardi Gjergj Fishta, 146 | Tiranë | Albania

T +355 (0) 44803939

VAT L51511004F

Kapitali social i derdhur i plote 1.400.000 LEK

www.armundiagroup.com | www.armundiafactory.com

Bulevardi Gjergj Fishta, 146 | Tiranë | Albania

T +355 (0) 44803939

VAT L51511004F

Fully paid share capital 1.400.000 LEK



pësojnë hakmarrje; (d) "Ndhmës" është çdo person që ndihmon sinjalizuesin në mënyrë konfidenciale gjatë procesit; (dh) "Njësia përgjegjëse" është pala e tretë e jashtme e caktuar nga Shoqëria, e ngarkuar me shqyrtimin dhe hetimin administrativ të sinjalizimit dhe ndjekjen e tij; (e) "Ndjekje" është çdo veprim i njësisë përgjegjëse për të vlerësuar saktësinë e pretendimeve dhe për të trajtuar shkeljen; (ë) "Hakmarrje" është çdo veprim ose mosveprim, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, që i shkakton ose mund t'i shkaktojë dëm sinjalizuesit dhe që lidhet me sinjalizimin; (f) "ILDKPKI" është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, autoriteti kompetent për sinjalizimin e jashtëm dhe mbrojtjen nga hakmarrja.

## **KREU II — Parimet**

### **Neni 5 — Parimet e sinjalizimit**

Veprimtaria e sinjalizimit udhëhiqet nga parimet e: (a) ruajtjes së konfidencialitetit të identitetit të sinjalizuesit dhe të çdo informacioni të përfshirë në sinjalizim; (b) integritetit, paanshmërisë dhe pavarësisë gjatë shqyrtimit; (c) mirëbesimit të sinjalizuesit; (ç) mbrojtjes efektive të sinjalizuesit nga çdo formë hakmarrjeje; (d) aksesit të lehtë, të sigurt dhe gjithëpërfshirës në kanalet e sinjalizimit; (dh) trajtimit të shpejtë, të besueshëm dhe brenda afateve ligjore të çdo sinjalizimi.

## **KREU III — Njësia Përgjegjëse**

### **Neni 6 — Njësia përgjegjëse**

Shoqëria e cakton njësinë përgjegjëse për sinjalizimin një palë të tretë të jashtme, në zbatim të nenit 14, pika 8, të Ligjit dhe pikës 7 të Udhëzimit. Njësia përgjegjëse është OnLawOffice — Av. Orjon Nallbati (Licencë Nr. 6656), avokat i licensuar, i cili plotëson kriteret e pikës 20 të Udhëzimit: ushtron profesionin e avokatisë i licensuar; ka përvojë profesionale mbi 2 vjet; është i padënuar me vendim të formës së prerë; zotëron njohuri mbi ligjin për sinjalizimin, Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave; dhe gëzon integritet të lartë profesional. Marrëdhënia juridike midis Shoqërisë dhe njësisë përgjegjëse rregullohet me marrëveshje të posaçme me shkrim (pika 7).

### **Neni 7 — Pavarësia**

Njësia përgjegjëse gëzon pavarësi të plotë në ushtrimin e kompetencave të saj, veçanërisht në rastet kur sinjalizimi lidhet me veprimtarinë e punëdhënësit ose përfshin masa për mbrojtjen e



sinjalizuesit (neni 15, pika 2). Ajo ushtron funksionin me ndershmëri, integritet, paanshmëri dhe efikasitet, e lirë nga çdo ndikim i padrejtë (pika 11/b e Udhëzimit).

### **Neni 8 — Detyrat e njësisë përgjegjëse**

Njësia përgjegjëse ka detyrimin: (a) të pranojë, regjistrojë dhe konfirmojë marrjen e sinjalizimit brenda 7 ditëve nga paraqitja; (b) të ndjekë çështjen dhe të informojë sinjalizuesin për ecurinë e rezultatit përfundimtar jo më vonë se 3 muaj nga konfirmimi; (c) të sigurojë funksionimin e sigurt të kanaleve dhe ruajtjen e konfidencialitetit; (ç) të sigurojë informacion të qartë mbi procedurat e raportimit dhe masat e mbrojtjes; (d) të informojë automatikisht sinjalizuesin për veprimet e ndjekjes dhe arsyetimin përkatës (neni 15, pika 1); (dh) të paraqesë raportin vjetor pranë ILDKPKI-së deri më 15 janar (neni 14, pika 12).

## **KREU IV — Kanalet dhe Procedura e Sinjalizimit**

### **Neni 9 — Kanalet e sinjalizimit**

Shoqëria garanton akses në të gjitha format e sinjalizimit, përfshirë ato verbale, me shkrim ose përmes mjeteve të tjera të njohura të komunikimit (neni 14, pika 5). Për këtë qëllim vihen në dispozicion: (a) një adresë elektronike e dedikuar; (b) një formular fizik ose elektronik; (c) mundësia e raportimit verbal, i cili dokumentohet me shkrim nga njësia përgjegjëse. Kanalet organizohen në mënyrë të tillë që të garantojnë konfidencialitetin dhe të parandalojnë aksesin e paautorizuar.

### **Neni 10 — Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit**

Sinjalizimi përmban, për aq sa është e mundur: të dhënat e identitetit dhe të kontaktit të sinjalizuesit; përshkrimin e fakteve e rrethanave të shkeljes së dyshuar, shoqëruar me provat përkatëse; dhe referencat ligjore përkatëse. Kur sinjalizimi nuk plotëson formën e kërkuar, sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigojë të metat brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit.

### **Neni 11 — Sinjalizimi anonim**

Shoqëria pranon dhe trajton sinjalizimet anonime në të njëjtat kushte si çdo sinjalizim tjetër, sipas nenit 17 të Ligjit, me kusht që të dhënat e raportuara të sigurojnë një bazë të mjaftueshme për hetim. Sinjalizuesi që zgjedh të mbetet anonim por mund të identifikohet, gëzon të njëjtën mbrojtje nëse identiteti i tij zbulohet më vonë.

### **Neni 12 — Konfirmimi dhe afatet**

Njësia përgjegjëse konfirmon marrjen e sinjalizimit brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes, përveç rasteve kur sinjalizuesi ka kërkuar shprehimisht të mos marrë konfirmim ose kur



konfirmimi rrezikon mbrojtjen e identitetit të tij (neni 15, pika 1, shkronja "a"). Njësia informon sinjalizuesin për ecurinë dhe rezultatin përfundimtar jo më vonë se 3 muaj nga data e konfirmimit (neni 15, pika 1, shkronja "b").

### **Neni 13 — Sinjalizimi i jashtëm**

Pavarësisht nga kanali i brendshëm, sinjalizuesi ka të drejtë t'i drejtohet drejtpërdrejt ILDKPKI-së si autoritet kompetent për sinjalizimin e jashtëm, si dhe, sipas rastit, institucioneve të Bashkimit Evropian. Shoqëria nxit përdorimin e kanalit të brendshëm kur shkelja mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda saj dhe kur nuk ekziston rrezik hakmarrjeje, por nuk e kufizon në asnjë rast të drejtën e sinjalizuesit për raportim të jashtëm (neni 14, pika 4).

## **KREU V — Të Drejtat, Mbrojtja dhe Përgjegjshmëria**

### **Neni 14 — Të drejtat e sinjalizuesit**

Sinjalizuesi gëzon të drejtën e konfidencialitetit gjatë gjithë procesit, ruajtjes së identitetit, mbrojtjes nga hakmarrja dhe informimit për ecurinë e çështjes, pavarësisht nga mekanizmi i përdorur (neni 6 dhe neni 7 të Ligjit). Çdo rregull ose marrëveshje që përjashton ose kufizon këto të drejta është e pavlefshme.

### **Neni 15 — Veprimet hakmarrëse të ndaluara**

Ndalohet çdo veprim hakmarrës ndaj sinjalizuesit, përfshirë: shkarkimin nga puna; pezullimin nga detyra; transferimin ose ndryshimin e orarit; uljen në detyrë; uljen e pagës ose shpërblimeve; humbjen e statusit profesional; mohimin e ngritjes në detyrë; përjashtimin nga trajnimet; vlerësimin negativ; intimidimin, ngacmimin ose presionin psikologjik; diskriminimin; mosrinovimin ose përfundimin e kontratës; dëmtimin e reputacionit; përfshirjen në "listë të zezë"; anulimin e licencës; referimin e pajustificuar për ekzaminim mjekësor; izolimin profesional; si dhe kërcënimin ose përpjekjen për secilin prej tyre (neni 8, pika 1, dhe neni 23 të Ligjit). Çdo akt i tillë është i pavlefshëm.

### **Neni 16 — Procedura e mbrojtjes nga hakmarrja**

Shqyrtimi i kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse është kompetencë e ILDKPKI-së si autoritet kompetent, sipas nenit 22 të Ligjit. Sinjalizuesi që vlerëson se është bërë objekt hakmarrjeje paraqet kërkesë për mbrojtje pranë ILDKPKI-së. Shoqëria detyrohet të bashkëpunojë plotësisht me ILDKPKI-në dhe, me kërkesë të saj, të provojë se masat e marra ndaj sinjalizuesit janë ndërmarrë për arsye të ligjshme dhe të pavarura nga sinjalizimi; barra e provës bie mbi Shoqërinë (neni 22, pika 9, dhe neni 23, pika 7). Nëse sinjalizuesi kërkon



zhvendosjen në një njësi tjetër për shkak të krijimit të një mjedisi pune armiqësor, Shoqëria merr masat e nevojshme për realizimin e saj (neni 8, pika 3).

### **Neni 17 — Sinjalizimi në keqbesim**

Mbrojtja e parashikuar nga Ligji u njihet sinjalizuesve që veprojnë në mirëbesim. Sinjalizimi kryhet me përgjegjshmëri, pa shpifur, pa mashtruar dhe pa dhënë informacion të rremë në dëm të personave të përfshirë (neni 24, pika 1, të Ligjit). Paraqitja me vetëdije e plotë e informacionit të rremë ose të pasaktë nuk gëzon mbrojtjen e Ligjit, përbën shkak për mosfillimin ose përfundimin e hetimit (neni 21 të Ligjit) dhe mund të sjellë pasoja disiplinore, si dhe përgjegjësi për kompensimin e dëmit ndaj personave të përfshirë (neni 24, pika 2, të Ligjit).

## **KREU VI — Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e të Dhënave**

### **Neni 18 — Konfidencialiteti**

Identiteti i sinjalizuesit dhe çdo e dhënë e përfshirë në sinjalizim ruhen në kushte konfidencialiteti dhe mund të zbulohen vetëm me pëlqimin e tij të shprehur. Identiteti i personit të përfshirë ruhet po ashtu në konfidencialitet. Zbulimi pa pëlqim lejohet vetëm kur është i domosdoshëm, i arsyetuar dhe proporcional për nevoja të hetimit penal ose të procesit gjyqësor, dhe vetëm pasi sinjalizuesi të jetë njoftuar paraprakisht me shkrim, përveç rasteve kur njoftimi rrezikon hetimin (neni 10 të Ligjit).

### **Neni 19 — Mbrojtja e të dhënave personale**

Të dhënat personale përpunohen vetëm për qëllimet e zbatimit të Ligjit dhe në përputhje me Ligjin Nr. 124/2024 dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian në masën që bëhet i zbatueshëm nëpërmjet marrëdhënieve ndërkombëtare të grupit. Trajtohen si të dhëna personale jo vetëm të dhënat identifikuese, por edhe vetë përmbajtja e sinjalizimit, deklaratat e dëshmitarëve, shpjegimet e personit të përfshirë dhe raportet e hetimit. Të dhënat që nuk janë të nevojshme nuk mblidhen; nëse mblidhen rastësisht, fshihen pa vonesë. Në rast konstatimi të shkeljes së legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 11 të Ligjit).

### **Neni 20 — Ruajtja e dokumentacionit**

Sinjalizimet dhe dokumentacioni përkatës regjistrohen dhe ruhen për një periudhë 5-vjeçare nga data e komunikimit të rezultatit përfundimtar, në kushte sigurie dhe konfidencialiteti, sipas nenit 12 të Ligjit. Pas përfundimit të afatit 5-vjeçar, dokumentacioni asgjësohet ose anonimizohet, sipas procedurës së ruajtjes dhe asgjësimit të dokumenteve të Shoqërisë.



## **KREU VII — Raportimi dhe Dispozita të Fundit**

### **Neni 21 — Raporti vjetor**

Njësia përgjegjëse harton dhe paraqet pranë ILDKPKI-së, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raportin vjetor të konsoliduar për sinjalizimet e marra dhe trajtimin e tyre, sipas formatit të përcaktuar nga ILDKPKI-ja (neni 14, pika 12).

### **Neni 22 — Trajnimi**

Njësia përgjegjëse i nënshtrohet trajnimit të detyrueshëm në fushën e sinjalizimit, sipas kalendarit të trajnimeve të njoftuar paraprakisht nga ILDKPKI-ja (pika 24 e Udhëzimit). Shoqëria merr masa për ndërgjegjësimin e punonjësve mbi ekzistencën dhe funksionimin e mekanizmit.

*Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja NUK është kompetencë e njësisë përgjegjëse. Sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 96/2025, kjo kompetencë i takon ILDKPKI-së. Roli i Shoqërisë kufizohet në bashkëpunim dhe në përmbushjen e barrës së provës sipas nenit 22, pika 9.*

### **Neni 23 — Hyrja në fuqi dhe rishikimi**

Kjo rregullore miratohet me vendim të administratorit të Shoqërisë dhe hyn në fuqi në datën e miratimit. Aktet e mëparshme që bien në kundërshtim me të, përfshirë rregulloret e miratuara në zbatim të Ligjit Nr. 60/2016, shfuqizohen. Rregullorja rishikohet sa herë që ndryshon kuadri ligjor ose dalin udhëzime të reja të ILDKPKI-së.

### **Miratuar nga administratori i Shoqërisë**

---

**Stavri Pici**

*Administrator — Armundia Factory sh.p.k.*